



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:009197

Datë: 29.05.2019

Numri i dokumentit: 00335007

PKR. nr. 47/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- Departamenti për Krime të Rënda- në përbërje të Gjyqtarit Gëzim Pozhegu si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve profesionist Manduhije Syla dhe Diana Sina-anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.B., Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale: Trafikim me njerëz nga neni 139 paragrafi 5 të ish Kodit penal të Kosovës, i akuzuar nga Prokuroria Speciale të Kosovës në Prishtinë, PPS.nr.63/11 të datë 03.05.2011, në seancën e shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 15.04.2019, në praninë prokurores së Prokurorisë Speciale të Kosovës, Merita Bina – Rugova, të akuzuarit F.B. dhe mbrojtësit të tij avokatit B.T. nga Prishtina, me datë **18.04.2019** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **29.05.2019**, përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F.B.**, i biri i F. dhe nënës F., e gjinisë B., data e lindjes..., Komuna e Prishtinës, ku edhe banon, numer personal..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion-Tregtar, i martuar, baba i 1 fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë.

Është Fajtor

Se nga muaji qershor i vitit 2010 e deri më datën 17.08.2012, duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme, me qëllim të fitimit dobisë financiare kanë trafikuar njerëz – shtetase të Moldavisë, ashtu që i akuzuari R.Th. , H.Th., A.U., B.D., i kanë sjellur femrat e trafikuar në Kosovë dhe atë : K.G., N.D., E.G., K.B., K.K., T.S., K.C., K.T., T.D., D.C., T.V., L.D., M.M., I.F., D.Ch., Z.Ch., M.T., N.N., O.Ch., T.D., M.T.dhe M.C.dhe pasi iu kanë rregulluar dokumentet për qëndrim dhe për punë në Kosovë, i kanë punësuar të njëjtat dhe i kanë pranuar apo vendosur për të banuar në lokalet :‘L.’ pronar i të cilit është i akuzuari R.Th., ‘B.’ pronar i të cilit është i akuzuari H.Th., ‘ M.’ pronar i të cilit është i akuzuari A.U. dhe ‘ V.’ pronar i të cilit është i akuzuari B.D., të cilat lokale gjinden në Gjakovë dhe pastaj i akuzuari

R.Th., në bashkëpunim me A.B.1., i akuzuari H.Th. në bashkëpunim me të akuzuarin E.Th., i akuzuari A.U. në bashkëpunim me të akuzuarin L.Th. dhe i akuzuari B.D. në bashkëpunim me të akuzuarin Z.R. duke shfrytëzuar pozitën e ndjeshme – të varfër materiale të femrave të trafikuar i kanë shfrytëzuar ato, duke i detyruar apo duke u marr vesh me to që të njëjtat tu ofrojnë shërbime seksuale personave –klientëve të ndryshëm, në mesin e të cilëve edhe të akuzuarit : F.B. , M.B., M.N., si dhe dëshmitarëve bashkëpunues : N.H., E.M., A.B.1., A.B.2. dhe A.Sh., të cilët ishin në dijeni se ato po shfrytëzoheshin seksualisht dhe të cilët pagesën për shërbime seksuale, ku përfshihet edhe pagesa e pijeve për femra në shumë prej 120 euro, i bënin në lokalet “B., “M.”, “L.” dhe “ V.” dhe pas pagesës shkonin në motele tjera, duke përfshirë edhe hotelin “E.” pronar i të cilit është i akuzuari M.N., për ti pritur femrat e trafikuar, të cilat i dërgonin taksitë e kompanive nga Gjakova, të cilët i dërgonin femrat nëpër vende ku ato kërkojshin për ti dërguar për ndonjë punë apo për shfrytëzim seksualisht.

- **Me çka ka kryer veprën penale Trafikim me njerëz nga neni 139 par. 5 të ish KPK-së.**

Andaj, Gjykata në kuptim të nenit **3, 6, 11, 15, 23, 34, 38, 41, 45, 71, 73, 139 par.5** të KPK-së si dhe **neneve 365,366, 368, 450** të KPPK-së, të akuzuarin F.B. e

G J Y K O N

ME DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ NJË (1) VITI, i cili dënim duhet të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform të nenit 450 par.4 të KPPK-së, i akuzuari obligohet që të paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej njëzetepesë (25) € si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetepesë (25) € gjithsejtë pesë dhjetë (50) €, dhe shumë prej pesëdhjetë (50) € në emër të kompensimit të viktimave të krimit, konform neni 39 par.3, nënpar.3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e cila shumë duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Kosovës në Prishtinë, me aktakuzën PPS.nr.63/11 datës 03.05.2011, ka akuzuar F.B., Komuna e Prishtinës, etj., si në aktakuzë, për shkak të veprës penale: Trafikim me njerëz nga neni 139 paragrafi 5 të ish Kodit penal të Kosovës.

Ndaj të akuzuarve F.B., K. Prishtinë dhe M.B., K.Deçan, të akuzuar për veprën penale trafikim me njerëz nga neni 139 par.5 të ish Kodit Penal të Kosovës. Gjykata në bazë të nenit 36 të Kodit të Procedurës Penale, me aktvendimin PKR.nr.196/13 të datës 23.09.2013, ka veçuar procedurën penale e cila ishte duke u shqyrtuar pran kësaj gjykate, në atë mënyrë që është formuar lënda e veçant dhe ka marrë numër të ri të veçantë PKR.nr.303/13.

Gjykata lidhur me këtë çështje ka marrë Aktgjykimin PKR.nr.303/13 datë 06.04.2018 në bazë të ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit F.B. av.B.T., PKR.nr. nr.303/ 2013 të dt.19.korrik 2018,

dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës PKR nr.303/2013 datë 31.05.2019. Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktgjykimin PAKR.nr.330/18 datë 07.09.2018, e ka kthyer në rigjykim.

Prokurorja e Prokurorisë e Prokurorisë Speciale të Kosovës deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor ka mbetur pranë aktakuzës.

I akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale trafikim me njerëz nga neni 139 par.5 të ish KPK-së.

Në fjalën hyrëse Prokurorja e PS ka deklaruar :

Se mbetet në tërësi pranë fjalës hyrëse pranë shqyrtimeve të mëparshme, konsideron se ka prova të mjaftueshme që argumentojnë që i akuzuari të ketë kryer veprën penale, meqenëse i njëjti kur ka dhënë deklaratën e tij në hetuesi ka pranuar fajësinë, duke deklaruar se ka shfrytëzuar shërbimet e femrave të cilat kanë qenë të trafikuar tek R.Th., kështu që propozojë që të vazhdohet me administrimin e provave.

Në fjalën hyrëse mbrojtësi i të akuzuarit F.B. , av.B.T.nga Prishtina ka deklaruar :

Ne edhe më herët kemi shtuar dhe deklaruar se e kundërshtojmë aktakuzën. Pretendojmë se në fund të këtij procesi gjyqësor, i akuzuari do të shpallet i pafajshëm për shkak se veprimet e tij as individualisht e as komulativisht nuk përbëjnë vepër penale, propozojë që si pjesë integrale të fjalës hyrëse të merren fjalët hyrëse në procesverbalet e mëparshme.

Në fjalën hyrëse i akuzuari F.B. ka deklaruar: se e mbështetë në tërësi fjalën hyrëse të mbrojtësit dhe nuk ka tjetër çka të shtojë.

Prokurorja e PS Merita Bina – Rugova në fjalën përfundimtare ka deklaruar :

Se mbetet pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin gjyqësor paraprak të mbajtur në këtë gjykatë me dt. 03.04.2018, ku ka deklaruar:

Konsiderojë se gjatë këtij shqyrtimi kryesor me provat e administruara është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë. Kjo është vërtetuar përmes deklaratave të dëshmitarëve, A.B.1. dhe N.H., edhe pse dëshmitari N.H. ka tentuar që ta ndryshojë deklaratën e vet të dhënë gjatë hetimeve dhe në këtë mënyrë ti ndihmojë të akuzuarit F.B. që ti ik përgjegjësisë penale, është e çartë se në këtë pjesë të deklaratës së tij , gjykata nuk duhet ti besojë sepse është në kundërshtim me provat tjera, për dallim prej këtij dëshmitari tjetër A.B.1. i ballafaquar me transkriptuat e bisedave të tij të zhvilluara me të akuzuarin F.B. ka dhënë përgjigje të çartë dhe konkrete se është e vërtetë që kanë zhvilluar biseda të tilla, përveç kësaj gjendja faktike dëshmohet edhe me transkriptuat e bisedave telefonike të cilat i akuzuari i ka zhvilluar me pronarin e lokalit tani të dënuarin R.Th. si dhe me dëshmitarin A.B.1.

Dhe në fund konsiderojmë se një provë shumë të rëndësishme për këtë çështje penale paraqesin edhe deklaratat e mëhershme të akuzuarit F.B., i cili në detaje e ka përshtuar mënyrën e shfrytëzimit të shërbimeve seksuale të femrave të ndryshme në lokalit e R.Th. Andaj mbetem në tërësi pranë aktakuzës, kërkojë që i akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe të dënohet sipas ligjit duke marrë parasysh si rrethanë rënduese edhe faktin se edhe më herët ka qenë i dënuar.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit F.B. , av.B.T.ka deklaruar:

I akuzuari F.B. së bashku me 22 të akuzuar të tjerë në mesin e tyre edhe me R.Th. dhe A.B.1. janë akuzuar për veprë penale si në aktakuzë. Raportet e të akuzuarit me R.Th. n dhe A.B.1. kanë qenë të këqija për shkak të borxhit që F.B. i kishte shitur veturë R.Th. Kontaktet e shpeshta kanë qenë me qëllim të kthimit të borxhit.

Policia të akuzuarin e ka thirre në cilësinë e dëshmitarit dhe e ka njoftuar gojarisht se pyetet për borxhin që i ka R.Th., në atë situatë, pa avokat dhe duke konsideruar se kjo deklaratë e tij kundër R.Th. i ndihmon në nxjerrjen e borxhit, ka dhënë deklaratë si në procesverbal, në fund të intervistës policia e kanë përcaktuar statusin e tij, e kanë konsideruar të pandehur dhe vetëm e ka nënshkruar deklaratën, konform ligjit nenit 53 par.3 edhe ish KPP është provë e papranueshme.

Deklarata tjera të dhëna në polici dhe prokurori nuk janë nxjerr në frymën e ligjit, nuk janë artikulum i vullnetit të të akuzuarit, rezultojnë me gabime teknike dhe përmbajtjesore, proceset janë nënshkruar pa lexuar e në mirëbesim dhe në asnjë fazë nuk është deklaruar përgjegjës për veprimet e tij, as që i ka pranuar veprimet që ka pasur marrëdhënie seksuale dhe për këtë edhe nuk ka prova .

E konsiderojmë të kundërligjshëm dëgjimin e dëshmitarëve R.Th. dhe A.B.1., për shkak se janë të bashkë të akuzuar dhe të dy dëshmitarët janë shpallur fajtor, e që në dispozitiv të vendimit PKR.nr. 90/15 thuhet se duke shfrytëzuar pozitën e ndjeshme materiale të femrave të trafikuar iu kanë ofruar shërbime seksuale të akuzuarit F.B., M.B. etj.

Marrja e deklaratave e të këtyre 2 dëshmitarëve në këtë gjykatë dhe në pyetje të prokurorisë ata kanë qenë nën presionin e deklaratave të mëhershme të cilat i kanë dhënë si të pandehur, por në esencë nuk e kanë inkriminuar të akuzuarin F.B. Nga procesverbalet e policisë dhe prokurorisë veprimet e të akuzuarit janë përshkruar sipërfaqësisht dhe jo në pyetje konform rregullave profesionale dhe ato nuk janë vullnet i tij.

Nga listingu i telefonave shumica e bisedave janë rreth borxhit ndërsa bisedat e datës 24.06.2012, të cilat kryesisht kanë qenë humor aty nuk është vërtetuar se kanë qenë biseda serioze, nuk është vërtetuar se ka qenë i përgjegjshëm për deklaratimet e tij, dhe në esencë edhe nuk e ka të njohur edhe sot faktin që ka biseduar, por iu fal besimin shkresave të lëndës, edhe pse nuk kemi ekspertizë që vërteton që personi në ato biseda është F.B., pavarësisht që natën kritike ka qenë i dehur dhe është vendosur në një dhomë derisa ti kalojë dehja. Për këtë arsye kemi propozuar si provë që prokuroria ta tregojë identitetin e palëve të dëmtuara nëse ka, për të vërtetuar që i akuzuari ka kryer marrëdhënie seksuale me to, për këtë edhe kemi kërkuar që nëse ka palë të dëmtuara ato të japin deklaratë në gjykatë. Nga shkresat e lëndës asnjë nga femrat që janë konsideruar të trafikuar nuk e ka përmendur F.B., por me emra dhe mbiemra kanë përmendur persona tjerë, ndërsa një prej dëshmitarëve M.C., ajo është deklaruar se e njeh, por nuk ka pasur punë me te.

Mungesa e provave vërteton se akuza është e pabazuar dhe në përputhje me rekomandimet e Gjykatës së apelit, Aktvendimit PAKR.nr. 330/18 datë 07.09.2018, rekomandon që të bëhet komenti i listingu të telefonatave për të nxjerrur veprimet inkriminuese, e të cilat duhet të jenë vërtetuara veprimet, dhe në faqen 5 shprehimisht kanë rekomanduar në pasusin e fundit lexojë si në vijim. Në këtë kontest rezulton se janë të kundërligjshme deklaratat e dëshmitarëve dhe nga leximi i SMS-ve nuk është vërtetuar veprimet inkriminuese të të akuzuarit, dhe janë prova të papranueshme deklarata e të akuzuarit në fazën hetimore.

Deklarata e dëshmitarit N.H. pavarësisht që sipas nenit 127 të KPP-së ka mundur të mos jep deklaratë, mirëpo nuk e kemi kundërshtuar në interes të drejtësisë dhe ai shprehimisht ka deklaruar që F.B. nuk ka kryer marrëdhënie seksuale siç përshkruhet në aktakuzë më gjerësisht deklaratat e tij të dhëna në gjykatë.

Pas analizimit, konstatimit dhe sintetizimit të tërësishëm të rrjedhës së procesit penal, logjikshëm rrjedhshëm, bindshëm dhe përtej çdo dyshim, vërtetohet që akuza është e pabazuar dhe e pa arsyetuar në prova. Nyja e këtij procesi dhe zanafilla e saj është deklarata e vet të akuzuarit që në cilësinë e dëshmitarit e ka dhënë me datë 16.10.2012 në polici, duke dëshmuar kundër R.Th., i akuzuar në këtë proces penale, me të cilin ishte në konflikt borxhi, të cilën deklaratë e ka dhënë pa vullnet, pak i ndikuar e pak i mllëfosur për shkak të mos pagesës së borxhit. Kjo deklaratë duke u kopjuar dhe cituar kemi ardhur deri në këtë fazë të procedurës, asnjë provë nuk e ka vërtetuar që i akuzuari ka kryer veprën për të cilën është akuzuar, nuk ka palë të dëmtuara, asnjë femër, as indirekt nuk e ka përmendur emrin e tij për të keq. Transkriptet e telefonave kanë qenë biseda që i ka dhënë në ndikim të alkoolit dhe më tepër në ndikim humori e që gjatë pauzave edhe në restorant të pallatit të drejtësisë dëgjojnë biseda lidhur me marrëdhënie të dashurisë, por nuk akuzohen sepse nuk janë vepra penale meqë ka në bërë hajgare, në këtë kuptim ka bërë humor edhe i akuzuari F.B. me bashkë të akuzuarin A.B.1., ndërsa bisedat tjera që përshkruhen edhe në akuzë në faqen 143 këto janë të ndërlydhura dhe të shkëputura nga bisedat e tërësishme, e që iu referohen dyshimeve të F.B. ndaj një personi të cilin e ka hasur në restorant L. tek R.Th. dhe i cili ka ndërmjetësuar për një automjet dhe ndaj atij person i ka pasur dyshime se është agjent i policisë dhe do t'ia ofrojë me qëllim të keq veturën e vjedhur.

Asnjë provë tjetër, as individualisht as në tërësi komulativisht nuk përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Gjykatës i propozojmë që akuzën ta refuzojë si të pabazuar, për shkak se nuk është siguruar asnjë provë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari F.B. ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të parashtruar nga mbrojtësi i tij dhe njëherit ka shtuar se kërkon që aktgjykimin të jetë lirues ose të përsëritet procedura dhe ti ipet mundësia e nxjerrjes së provave të cilat u refuzuan nga gjykata.

I.GJENDJA E FAKTEVE

Në këtë çështje penale gjykata ka vërtetuar se : se nga muaji qershor i vitit 2010 e deri më datën 17.08.2012, duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme, me qëllim të fitimit dobisë financiare kanë trafikuar njerëz – shtetase të Moldavisë, ashtu që i akuzuari R.Th. , H.Th. , A.U. B.D., i kanë sjellur femrat e trafikuar në Kosovë dhe atë : K.G., N.D. , E.G. , K.B. , K.K.,T.S.,K.C. , K.T. , T.D. , D.C., T.V., L.D., M.M., I.F., D.Ch., Z.Ch., M.T., N.N., O.Ch., T.D., M.T.dhe M.C. dhe pasi iu kanë rregulluar dokumentet për qëndrim dhe për punë në Kosovë, i kanë punësuar të njëjtat dhe i kanë pranuar apo vendosur për të banuar në lokalet : “L.” pronar i të cilit është i akuzuari R.Th. , “ B.” pronar i të cilit është i akuzuari H.Th.“, M.“ pronar i të cilit është i akuzuari A.U.dhe “ V.” pronar i të cilit është i akuzuari B.D., të cilat lokale gjinden në Gjakovë dhe pastaj i akuzuari R.Th., në bashkëpunim me A.B., i akuzuari H.Th. në bashkëpunim me të akuzuarin E.Th., i akuzuari A.U.në bashkëpunim me të akuzuarin L.Th. dhe i akuzuari B.D. në bashkëpunim me të akuzuarin Z.R. duke shfrytëzuar pozitën e ndjeshme – të varfër materiale të femrave të trafikuar i kanë shfrytëzuar ato, duke i

detyruar apo duke u marr vesh me to që të njëjtat tu ofrojnë shërbime seksuale personave – klientëve të ndryshëm, në mesin e të cilëve edhe të akuzuarit : F.B. M.B., M.N., si dhe dëshmitareve bashkëpunues : N.H., E.M., A.B.1, A.B.2. dhe A.Sh., të cilët ishin në dijeni se ato po shfrytëzoheshin seksualisht dhe të cilët pagesën për shërbime seksuale, ku përfshihet edhe pagesa e pijeve për femra në shumë prej 120 euro, i bënë në lokalet ‘‘B.’’, ‘‘ M.‘‘ , ‘‘L.’’ dhe ‘‘ V.’’ dhe pas pagesës shkonin në motele tjera, duke përfshirë edhe hotelin ‘‘ E.’’ pronar i të cilit është i akuzuari M.N., për ti pritur femrat e trafikuar, të cilat i dërgonin taksitë e kompanive nga Gjakova, të cilët i dërgonin femrat nëpër vende ku ato kërkojshin për ti dërguar për ndonjë punë apo për shfrytëzim seksual.

Është vërtetuar se i akuzuari F.B. se bashku me shokët e tij N.H. dhe njëherë edhe me shokët D.B. nga K. Lipjan dhe A.D., K. Skenderaj, kanë shkuar në lokalin kafe bar ‘‘L.’’ pronë e R.Th. dhe kanë shfrytëzuar femrat për maradhënie seksuale edhe pse e kanë ditur se janë të trafikuar (pasi që këto femra të gjitha kanë qenë nga shtetet e Lindjes - MollDavis), ku shpenzimet për shfrytëzim seksual të femrave , pije, ushqim dhe hotele i ka paguar i akuzuari F.B. duke e zbatuar nga borxhi që ja kishte R.Th. , F. në emër të blerjeve të automjeteve.

Këtë gjendje të fakteve gjykata e ka vërtetuar në bazë të leximit dëshmisë të dëshmitarit R.Th. të dhënë në shqyrtim gjyqësor dt 15.02.2018, dëshmisë së dëshmitarit N.H. të dt.15.04.2019 dhe leximit dëshmisë të dëshmitarit N.H. të dt. 03.04.2018 dhe leximit dëshmisë të dëshmitarit A.B.1. të dt. 03.04.2018, dhe provave Listingjet: e datës 16.06.2012, të datës 30.06.2012, të datës 26.06.2012, të datës 26.06.2012, të datës 26.06.2012, të datës 28.06.2012, të datës 28.06.2012 ku është zhvilluar komunikimi në mes të dëshmitarit A.B.1. dhe F.B. , transkriptuat e bisedës të R.Th. me të akuzuarin F.B. dhe e datës 30.06.2012 . Gjatë shqyrtimit gjyqësor Gjkata i ka nxjerr të gjitha provat e duhura, ato i ka administruar dhe vlerësuar me vëmendje dhe pas vlerësimit të tyre të gjithanshëm secilës veç e veç, e në lidhje reciproke me provat tjera konform nenit 361 të KPPK, ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Dëshmitari R.TH.

Lexohet dëshmia e dhënë në shqyrtimin gjyqësor 15.02.2018
Në dëshminë e tij ka deklaruar:

Se e njeh F.B., se me F. kanë punuar me vetura-automjete, shit-blerje, kanë bashkëpunuar, R. i ka shitur F. plaka të betonit dhe vaj për makina, F. i ka shitur vetura, kështu që çështje biznesi. Gjatë biznesit nuk i kanë mbetur borxh njëri tjetrit. Në vitin 2012, ka mes i vitit, kanë pas borxh njeri tjetrit, se ata kanë punuar vazhdimisht, edhe sot punojmë i kom borxh e më ka. Kur kanë pasur borxh janë kompensuar ose me vetura ose me pare.

F., nuk ka shfrytëzuar shërbimet e vajzave në lokalin tim, ka ardh në lokalin tim si mysafir herë vetëm, e herë me shokë.

Në pyetjen e Prokurores: Ju e dini përmbajtjen e aktakuzës, e dini që numri i juaj ka qenë i përgjuar dhe keni pasur kontakte me të akuzuarin, si i shpjegoni ju përmbajtjen e bisedave ku shihet se F. shpeshherë ka qenë si mysafir në lokalin tuaj, ku keni përmendur kompensimin me femra. Dëshmitari në pyetjen e prokurores përgjigjet: Nuk është e vërtetë.

Prokurorja e ballafaqon me provën -transkriptuat e bisedës me të akuzuarin të dt. 28.06.2012 në orën 18:37 min, ku keni biseduar lidhur me vizitat që i keni bërë në lokalin tuaj nga ana e F.? Çka keni me thënë lidhur me këtë listing?, dëshmitari deklaroi: Këto kanë mundur me qenë

faturat që ka qenë në kazino dhe si kompensim i kom dhënë edhe kubëza të betonit ose vaj për makina.

Në pyetjen e prokurores Qysh e shpjegoni F. juve iu ka thënë : “Qysh bre R.” vet i treti për 2 orë - 2.000,00 €, ndërsa dëshmitari iu ka përgjigjur nuk kam qenë vet i treti, por nuk po muj me fol përmes telefonit. Dëshmitari përgjigjet: kemi bërë shaka në telefon, nuk ka të bëjë me pyetjen e prokurores.

Në pyetjet e mbrojtësi i të akuzuarit F.B., av. B.T. i parashtron pyetje dëshmitarit.

Po kemi shitur dhe blerë kerre në mes vete.

Kur ka ardhur në restorantin tim, F. ka ardhur me shok po ka ardh edhe vet, nuk ka pas shpenzime të shtrenjta, nuk e di saktë.

Në pyetjen çka mundesh me thonë për këto 1, 2 , 3, 4 ... 7 herë, të cilat u përmenden nga prokurorja, çka kupton me këtë?, dëshmitari përgjigjet: këtu bëhet fjalë për faktuarat, për të cilat ka marrë material dhe jo për punë tjera. Ka marrë kubëza të betonit, ka marrë vaj për makina.

Gjykata nuk ja falë besimin deklaratës së dëshmitarit R.Th., i cili në pyetjet e prokurores dhe palëve tjera në procedurë nuk ju është përgjigjur në mënyrë të vërtetë, por i njëjti me përgjigjet e tija të pa vërteta duke u munduar që të shmanget përgjigjeve të vërteta më qëllim që të mbroj të akuzuarin F. dhe duke i dhënë drejtim me përgjigjet e tija se gjëja është biseduar diçka tjetër apo bëhet fjalë për diçka tjetër e jo për femrat e trafikuar të cilat shfrytëzoheshin për marrëdhënie seksuale nga ana e të akuzuarit ku shpenzimet e shfrytëzimit seksual të femrave të trafikuar zbriteshin nga borxhi që R.Th. ia kishte këtu të akuzuarit F.

Se F.B. i ka shfrytëzuar femrat e punësuara të R.Th., shpenzimet për shfrytëzim të femrave të punësuara te R.Th. , për shërbime seksuale , i kanë zbatuar (llogarit) në borxhin që R. ia kishte këtu të akuzuarit F.B., vërtetohet edhe nga listingu i hyrje daljeve në mes të R. (dëshmitarit) dhe të akuzuarit F.B. Nga listingu i datës 28.06.2012. konstatohet se R.Th. ka komunikuar nga tel nr. ..., me personin NN me numër tel. ..., ku R. e njofton se deri qitash tu bo fjalë me ta kesh, personi NN me F. a pse, R. i thot: Po more , ju kishin pas ba 9018 euro aty plus 2000 euro përpara plus edhe nja 400 euro janë në hotel edhe 550 i ka F. borxh poj del edhe 900 e diçka euro mu la për mercedes.

Edhe nga kjo bised në mes të R.Th. dhe F.B. , konstatohet se F., ka zbatuar borxhin nga R. duke i shfrytëzuar punëtorët - femrat që kanë punuar në lokalin e R. në kafe bar L., për shërbimet seksuale dhe shpenzimet për ushqim dhe pije dhe hotele, kanë zbritur nga borxhi që ia kishte R.Th. të akuzuarit F.B. për blerjen e automjeteve nga F..

-Me listingun e datës 28.06.2012. (faqe 254) nga biseda e zhvilluar në mes të R.Th. t me numër të tel.... dhe F.B.me numër të tel. ..., konstatohet se R. dhe F. kanë biseduar rreth shpenzimeve të bëra me rastin e shpenzimeve për pije , hotele dhe shërbimet për maradhënie seksuale me vajzat e punësuara në lokalin e R.Th. t, F.B. së bashku edhe shokë . Ku R. i tregon F.t se kanë bërë shpenzime prej 9018 euro, ku i ka faturat për këto shpenzime. F. i kundërshton këto shpenzime duke i thënë se shpenzimet janë 5000- 6000 euro. R. i thot se vetëm një fatur e ke 2114 euro, kur keni qen tre shok, F. e kundërshton duke i thënë eksik 2000 euro dhe i thot se kemi qenë 5 herë, R. e kundërshton i thotë jo tash unë të tregoi sa herë ke qenë 1,2,3,4,5,6, 7 je kan 7 herë, F. ja kthen 7 herë ka dy mi 10 mi euro bajnë, R. jo 7 her ka 2 mi bajn 14 mi , 9018 janë këtu. F. banë vrejte qysh bre rem 2000 mi euro vet i treti per 2 sahat a. Këto janë shpenzimet e F.B. që janë shpenzua për shërbimet seksuale me punëtorët e kafe bar “L.”.

Dëshmitari N.H.

Lexohet dëshmia e dëshmitarit N.H. e dhënë më dt. 03.04.2018 pranë kësaj gjykate:
Se e njoh R.Th., është njoftuar përmes F. me R., nuk ka lidhje me te. Se ka qenë në lokalin e tij

Kam shkuar me F., R. i ka pas borxh F., jam friguar se mos po bënë fjalë me te, jam detyruar me shku me te meqenëse F. ka qenë i fejuar me vajzën time, dhe kemi shkuar , jemi zatet me to, herë vike e herë nuk vike me na taku, kështu u kon problemi. Kena shkuar me kërkua borxhin.

Po ka pas femra në lokal. Po me njëren kom pas dashuri me te.

Kemi shku , kemi pi poshtë se ka qenë edhe një lokal poshtë, mandej e thirrke F.R., : ai thoshte qe po vi, qe po vi, dhe shkon i naltë ngjituni se tash do të vij, Ne kemi shkuar naltë ku ishin femrat dhe kemi pirë dhe kemi ndejtë deri sa ka ardhur R.(R.).

Është e vërtetë se kemi ndejtë me femra por nuk kemi pas marrëdhënie me to.

Prokurorja ja përkujton se një herë ka dhënë deklaratë në Gjykatën Themelore DKR në Pejë tek gjyqtari i procedurës paraprake si dëshmitar bashkëpunues, procesverbalin e datës 07.02.2013, ku keni thënë : A ka pasur rast ku ju keni pasur marrëdhënie seksuale me ndonjë femër që ka punuar aty, përgjigja e juaj ka qenë : Po.

Dëshmitari N.H. përgjigjet, po është e vërtetë sikur ceka edhe më parë, unë kom pas dashuri me një femër dhe nuk kom paguar për te.

Prokurorja prapë e ballafaqojë dëshmitarin me deklaratën e tij të dhënë në procesverbalin e lartcekur, ku në pyetjen : A u dashtë me paguar këto femra për shërbime seksuale? , përgjigja e juaj ka qenë : Për këtë është marrë vesh F. dhe sa e di unë ai ka zbatuar nga 9.000,00 euro që i ka pasur borxh R., a është e vërtetë kjo. Dëshmitari përgjigjet sa i përket marrëdhënieve seksuale nuk është e vërtetë që F. ka paguar, por për pjesën tjetër çka keni pi, ngrënë është e vërtetë dhe ky borxh është zbatuar me borxhin që ia kishte R..

Prokuroja ja përkujton dëshmitarit se ti ke pasur disa deklarata, këtu është një deklaratë që ke dhënë në polici me dt. 18.10.2012 po ashtu në cilësinë e dëshmitarit, këtu prapë ke deklaruar njëjtë, sikur lexova më herët, p.sh. Në pyetjen e policit A ke marrë ndonjëherë ndonjë femër në lokal për marrëdhënie seksuale? Dhe ti ke thënë : citojë “Kemi shkuar së bashku me F. , ia kemi shitur R.Th. një veturë M. pastaj vinte R. thoshte : A po ju pëlqen ndo një femër, kur ne prananim, na thoshte : Shkoni pritini në Hotel E. dhe ato vijnë, kemi shkuar disa herë diku rreth 5-6 herë , ku na ka dërguar femrat R. me taksi, ne kemi pritur në dhomë”. Në pyetjen e prokurores a është e vërtetë kjo?

Dëshmitari përgjigjet, Jo nuk është e vërtetë kjo, policia muajin edhe me ndryshu, nuk ka pasur lidhje R. me mu, na kur kemi pi kafe në restorant është që kemi shkuar në hotel, se kemi qenë të dehur, aty unë një vajzë e kom dashtë, kemi bo dashni me to, edhe tjetër nuk kemi pasur. Nuk kam shkuar ndonjëherë vetëm, veç me F. kam shkuar .

Në pyetjen e prokurores, në deklaratën e njëjtë ku ju kanë bërë pyetjen e njëjtë : A keni paguar për këto shërbime, Përgjigja ka qenë : Nuk e di, F. është marrë vesh me R., por F. më ka thënë po i zbaton në emër të borxhit për veturë, A është e vërtetë kjo?. Dëshmitari përgjigjet, është e vërtetë.

Në pyetjen e prokurores, a ju kujtohet që keni qenë në Prokurorin Speciale dhe a iu kujtohet çka keni deklaruar?. Dëshmitari përgjigjet, ka kaluar kohë e gjatë, kam harruar.

Në Prokurori iu ka bërë pyetjen. A mbeteni pranë deklaratës së dhënë në polici me dt. 18.10.2012, dhe ju keni deklaruar : SE po mbetemi pranë deklaratës së dhënë. A është e vërtetë kjo?. Dëshmitari është përgjigjur, po qashtu u kon.

Në pyetjen e prokurores : A dini me lexua ju dhe a është ky nënshkrim i juaji në deklaratën e dhënë në polici me dt. 18.10.2012, pastaj në Gjykatë dhe në Prokurorinë Speciale. Dëshmitari përgjigjet Po, ky është nënshkrimi im si në procesverbalin e policisë, Prokurorisë dhe në Gjykatë.

Në pyetjet e mbrojtësi të akuzuarit F.B. , av.B.T., dëshmitari përgjigjet .
Arsyeja pse kemi shkuar te R.Th. me F., ka qenë se R. i kishte borxh F., dhe unë kam shkuar se u frikohesha, se duke u bazuar në bisedën e tyre telefonike, për arsye se nuk ia jepte parat R. F., F. nuk ka qenë i martuar, ka qenë vetëm i fejuar.
F., nuk ka pasur marrëdhënie me ndonjë femër , unë nuk kam parë, edhe nuk di a ka logjik meqenëse unë jam baballëku i tij dhe a është normale që unë mi pa atë duke bërë marrëdhënie me ndonjë femër tjetër. Nuk i pranojë deklaratat të cilat i kam dhënë në polici, prokurori si të vërteta.

Në pyetjen e kryetarit trupit Gjykses : Ju thatë në pyetjen e prokurores se i pranoni si deklaratat tuaja dhe të vërteta, deklaratat e dhëna në polici dhe prokurori, tani po thuani në pyetjen e avokatit se këto nuk janë të vërteta. Çka keni me thënë për këto.

Dëshmitari përgjigjet.: Është e vërtetë se R. i ka pas borxh F., po për femra jo.
Gjykata nuk ja falë besimin deklaratës së dëshmitarit N.H. të dhënë në seancën e dt. 03.04.2018, meqenëse dëshmitari në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit dhe një pjesë të pyetjeve prokurores është përgjigjur në atë mënyrë që me përgjigjet e tija është munduar që të mbron të akuzuarin F.B. ,të cilin tani e ka edhe dhëndër.

Gjykata ia fal besimin kur në pyetjen e prokurores dëshmitari e pranon se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici me datën 18.10.2012, ku edhe deklaroi se nënshkrimi në deklaratën e dhënë në polici me datë 18.10.2012 është i tij.

Në deklaratën e dhënë në polici në DKKO-DHTQNJ , 2012 dt. 18.10.2012, ku ndër të tjera deklaroi se e njef pronarin e lokalit "L." në Gjakovë, i cili quhet R.Th. , se i akuzuari F. i ka shitur veturat M. dhe A. dhe kur shkojshin për borxh te R. ai ju thoshte hypni nalt në lokal dhe kur vinte R. nalt ju thoshte a po ju pëlqen ndonjë femër kur ne pranonim se po ju pëlqen ju thoshte shkoni në hotel "E." në Gjakovë, dhe ato vinë. Se kanë shkuar 5-6 herë ku R. iu dërgonte femrat me taxi e këta pritëshin nëpër dhoma . Për punë të pagesës F. është marr vesh me R. , F. i ka thënë se shpenzimet për femra dhe pije e mund me ndodh edhe për marrëdhënie seksuale , po e zbaton me borxhin që ja kishte R. F.

Dëshmitari si dëshmitarë bashkëpunues në deklaratën e tij të dhënë te gjyqtari procedurës paraprake të gjykatës në Pejë, më dt. 07.02.2013, ka deklaruar se kanë qenë të R.Th., në lokalin e tij "L." në Gjakovë, diku 5-6 herë , ku R. me taksì, ju ka pru femrat të cilat punojshin te ai, kurse këta kanë pritë në dhoma të hotelit. Se për këto shërbime nuk kanë paguar, por këto shpenzime i kanë zbritur nga borxhi që R. ja kishte F. për shitjen e veturave.

Ka ndodhur edhe kur nuk ka qenë R. në lokal na kemi e shku në hotel dhe femrat kanë ardhur .

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.04.2019.

Dëshmitari N.H., në dëshminë e tij ka deklaruar;
Se mbetet pranë deklaratës së dhënë me dt. 03.04.2018.

Dëshmitari N.H. deklaroi se mbetet pranë deklaratës së dhënë para gjyqtarit të procedurës paraprake me datë 07.02.2013, në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues, ku ka deklaruar se kanë qenë të R.Th. , në lokalit të tij ‘ ‘ L.’ ’ në Gjakovë, diku 5-6 herë , ku R. ju ka prurë femrat të cilat punojshin te ai me taksë, kurse këta kanë pritur në dhoma të hotelit. Se për këto shërbime seksuale dhe shpenzimet e pijeve dhe hotelet nuk kanë paguar, por këto shpenzime i kanë zbritur nga borxhi që R. ja kishte F.

Av.B.T. i propozoi gjykatës që dëshmitarit ti lexohet procesverbal i dhënë para PS me datë 07.02.2013, që ta përkujtojë se çka ka thënë.

Prokurorja speciale Merita Bina-Rugova e deklaroi se e kundërshtojë propozimin e mbrojtësit av.B.T. që dëshmitarit ti lexohet dëshmia e dhënë në PS me dat. 07.02.2013, meqenëse dëshmitarit i kujtohet që ka dhënë dëshmi me të njëjtën datë, dhe është i kjo qëllimi i mbrojtjes i cili dëshiron tani që dëshmitari me deklaratën tjetër ta ndryshojë deklaratën e mëparshme në mënyrë që ta mbrojë të akuzuarin nga pjesët e saj eventuale me të cilat inkriminohet i njëjti.

Fjala është për një deklaratë të cilën dëshmitari e ka dhënë në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues, aq më parë kjo është një dëshmi shtesë që fjala është për një deklaratë të sigurtë dhe të vërtetë meqenëse është e dhënë pranë gjyqtarit të procedurës paraprake në prezencën e prokurorit dhe nuk ka aspak dilemë që i njëjti ka folur të vërtetën.

Në pyetjen e av.B.T.: A keni njohuri që ju me R.Th. keni folur për marrëdhënie seksuale me vajzat që kanë punuar tek R. ?

Dëshmitari përgjigjet: Unë e kom dhënë vërtetimin dhe po e jap prapë deri në fund, nuk kam çka të shtojë përveç asaj çka kam deklaruar më parë.

Pyetje : A ju kujtohet deklarata që keni dhënë para një viti?

Përgjigje: Ndoshta më kujtohet.

Pyetje.: Ju a keni njohuri se F.B. ka pasur marrëdhënie seksuale?

Përgjigje: Rri pranë deklaratës së dhënë në prokurori dhe para gjykatës.

I akuzuari F.B. deklaroi se nuk ka pyetje për dëshmitarin.

Dëshmitari si dëshmitarë bashkëpunues në deklaratën e tij të dhënë te gjyqtari procedurës paraprake në gjykatë në Pejë, më dt. 07.02.2013, ka deklaruar se kanë qenë të R.Th. , në lokalit të tij ‘ ‘ L.’ ’ në Gjakovë, diku 5-6 herë, ku R. ju ka prurë femrat të cilat punojshin te ai, kurse këta kanë pritur në dhoma të hotelit. Se për këto shërbime nuk kanë paguar, por këto shpenzime i kanë zbritur nga borxhi që R. ja kishte F. për shitjen e veturave.

Dëshmisë së dëshmitarit N.H., gjykata ja falë besimin kur deklarohet se mbetet pran deklaratimeve të dhëna si dëshmitarë bashkëpunues në deklaratën e tij të dhënë te gjyqtari procedurës paraprake në gjykatë në Pejë, më dt. 07.02.2013, si dhe dëshmisë të dhënë më dt. 03.04.2018 pranë kësaj gjykate:

Ku i njëjti ka deklaruar se kanë qenë të R.Th.. në lokalit të tij ‘ ‘ L.’ ’ në Gjakovë, diku 5-6 herë, ku R. ju ka prurë femrat të cilat punojshin te ai, kurse këta kanë pritur në dhoma të hotelit. Se për

këto shërbime nuk kanë paguar, por këto shpenzime i kanë zbritur nga borxhi që R. ja kishte F.për shitjen e veturave.

Dëshmitari A.B.1.

Lexohet dëshmia e dhënë në shqyrtimin gjyqësor 03.04.2018
Në dëshminë e tij ka deklaruar :

Se gjatë vitit 2012, ka punuar tek R.Th. , ka qenë roje në parking dhe ka pas me i shikuar lojërat e fatit, kamerier nuk ka qenë. Ndonjëherë kam bërë ndonjë shërbim, kur mu është kërkuar si kamerier.

Nuk e njeh F.B., nuk e ka njohur në atë kohë, ka harruar se a ka pas kontakte me F.B.. Përmes telefonit ka folur njëherë me te sa i kujtohet vetëm një herë. Nuk i kujtohet, se pse ka komunikuar me F. përmes telefonit dhe çka ka dashur F. prej tij.

Prokurorja ia ka përkujtuar dëshmitarit.: se Ju keni qenë i arrestuar në këtë lëndë penale (**e cila ka qenë e evidentuar me PPS.nr.63 /11 që ka të bëjë me këtë çështje penale, e cila çështje penale në këtë gjykatëka qenë e evidentuar PKR.nr.196/13 e kthyer në rigjykim PKR.nr.90/15**), atëherë e dinë që keni qenë të përgjuar, këtu në transkriptin e bisedave telefonike të zhvilluar me datë 26.06.2012, në orën 02:54 min., biseda në mes jush dhe F., ju keni pyetur F.: Hej cilën me ta pru atë me flokë të zeza apo me flokë të bardha? Përgjigja e F. : Me të bardha, ti prape e ke pyetur : Ajo e zaifta apo e shëndosha? dhe a është e vërtetë kjo, se a keni zhvilluar këto biseda në mes jush? Dëshmitari përgjigjet.: Po. Është e vërtetë po nuk më kujtohet.

Në pyetjen drejtuar dëshmitarit, a ka pasur raste të shpeshta ku F. ka kërkuar femra prej jush, dëshmitari përgjigjet: nuk më kujtohet.

Prokurorja ia përkujton përmbajtjen e transkriptit të bisedave telefonike : Me datën e njëjtë të lartcekur në orën 03:00min, prapë F. po pyet për atë femrën, ju jeni përgjigjur : U krye qitash edhe 2-3 minuta sa të bëhen gati. Pyetja e F. : A ish ajo e bardha, asaj S. dhe T. sa të vjen mi marrë ai., Pyetja e juaj : Në cilin vend jeni në të parin apo të dytën? Përgjigja e F. : Jemi në hotel E.. **Dëshmitari përgjigjet: nuk më kujtohet.**

Në pyetjen e Prokurores.: A po të kujtohet sa herë e ke pa F. në lokalin e R., dëshmitari përgjigjet: nuk po më kujtohet, vetëm kur më ka thirre në telefon, se në lokal nuk e kom pa, nuk e di qysh e ka marrë numrin tam të telefonit.

Në pyetjen e Prokurores: A ka qenë diçka e zakonshme që klientët të kërkojnë në telefon prej jush diçka, dëshmitari përgjigjet: nuk e di.

Në pyetjen e Prokurores.: A ka pasur raste të shpeshta që kanë kërkuar femra prej teje, pasi ke qenë rojtar në parking, dëshmitari përgjigjet: nuk më kujtohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.B. , av. B.T., i parashtroi pyetje dëshmitarit.

Në pyetjen e av. B.T.: Me lejen e juaj vetëm kisha me lexuar disa pyetje të cilat janë parashtruar nga KTGJ në procesverbalin e dt. 24.03.2014, faqe 1,2,3, ku jeni përgjigjur në pyetjet e KTGJ. A mbeteni pranë përgjigjeve të dhëna në procesverbalin e datës 24.03.2014?

Prokurorja speciale bënë vërejtje, duke cekur se këto përgjigje dëshmitari i cekur i ka dhënë në cilësinë e të akuzuarit dhe nuk është e drejtë që ato pyetje ti parashtrohen edhe në seancën e sotme nga ana e juaj.

Dëshmitari përgjigjet: nuk më kujtohet.

Në pyetjen ; A të ka lypë ndonjëherë F. femra, përmes telefonit?

Dëshmitari përgjigjet: Jo, nuk jom kon unë për ato sene, kam punuar roje, dhe parkingun e kerreve, agregatat dhe kajotat.

Në pyetjen; A e njeh ti naj person me emrin L.?

Dëshmitari përgjigjet: Jo, nuk e njoh. Kom ndi diçka, se njëfarë lapoqi i ka pasur borxh F., po nuk e njoh L..

Në pyetjen: A e njeh ndonjë person me emrin S.1. apo S.2.?

Dëshmitari përgjigjet: Jo nuk e njoh.

Kryetari trupi gjykues: Ju po thuani që F. nuk e njihni. A ju kujtohet se a ka pirë ndonjëherë F. në lokal, dëshmitari përgjigjet: Jo.

Në pyetjen : A ju kujtohet se F. ndonjëherë ka pirë më shumë, dhe ka shkaktuar ndonjë dëm në lokal?. Dëshmitari përgjigjet: nuk më kujtohet.

Në pyetjen e Kryetarit trupit gjykues.: Se të njëjtën datë në orën 04:28 min, i keni thënë R., F. ia nisi me thy gastare? Ti ke thënë : Se F. ka qenë pitë. A po të kujtohet? dëshmitari përgjigjet: Po është e vërtetë.

Gjykata, ja fali pjesërisht besimin deklaratës së dëshmitarit, pasi që dëshmitari në shumicën e pyetjeve të parashtruara mundohet që t'iu shmanget përgjigjeve duke u deklaruar nuk me kujtohet.

Gjykata ja falë besimin dëshmitarit kur deklaron:

Se ka biseduar me F. në telefon kur F. e ka thirr dhe e ka pyetur për femrat.

Dhe kjo vërtetohet edhe në bazë të transkriptit të bisedave telefonike të zhvilluara me datën 26.06.2012, në orën 02:54 /h, në bisedën në mes dëshmitarit A.B.1.dhe F., ku e ka pyetur F.: Hej cilën me ta pru atë me flokë të zeza apo me flokë të bardha? Përgjigja e F. ; Me të bardha, prape e ka pyetur : Ajo e zaipta apo e shëndosha?

Duke e bazuar në dëshmitë e lartcekura të dëshmitarit gjykata vërteton se i akuzuari F.B. , ka qenë në lokalin e të akuzuarit (tani të dënuarit R.Th.) dhe në emër të borxhit që i kishte R.Th. , në emër të shitblerjes së automjeteve, ka shfrytëzuar femrat e trafikuar, për marrëdhënie seksuale edhe pse e ka ditur femrat të cilat ishin të punësuara në lokalin K. B. ‘‘ L. ’’ pronë e R.Th., janë të trafikuar pasi që edhe në bisedën telefonike që është vërtetuar në listingun e dt. 26.06.2012, F. e pyet A.B.1.: A ish ajo e bardha, asaj S. dhe T. sa të vjen mi marrë ai., Pyetja e A. : Në cilin vend jeni në të parin apo të dytën? Përgjigja e F.t : Jemi në hotel E.. Në këtë rast i akuzuari F. e ka ditur se femrat kanë qenë të trafikuar nga shtet: Moldavia , etj. Po ashtu në këtë rast F. duke i shfrytëzuar femrat që kanë punuar në lokalin e R.Th., për marrëdhënie seksuale, me vetëdije ka kompensua (zbritur) borxhin, që ja kishte R.Th. .

PROVAT MATERIALE

-Me listingun e datës 26.06.2012,(faqe 224,) konstatohet se F. përmes telefonit të tij me nr., ka biseduar me A.B.1.i cili ka poseduar tel.nr. ... i cili ka qenë i punësuar në kafe barin e R.Th., ku F. ka pyetur A. a e ki qatu R., A. ju ka përgjigjur jo ka shkuar me fjete, F. e pyet A. e

L., A. përgjigjet ka shkuar në shtëpi, F. e pyet A., po na banë naj derdhi L. more, se R. me pruni në besë.

-Me listingun e datës 26.06.2012,(faqe 227) konstatohet se F. përmes telefonit të tij me nr., ka biseduar me A.B. i cili ka poseduar tel.nr. ... i cili ka qenë i punësuar në kafe barin “ L. “ pronë e R.Th.

Klienti-F. Pastaj pyet a janë nisë, A.përgjigjet qe edhe pak deri sa të vjen ai (taksi) prej qytetit mi marr.

Klienti-F.: hajt thirre at te q.... nane mos let të vonohet se u ba ora 4 kater, A. përgjigjet: se ato jan gati.

-Me listingun e datës 26.06.2012, (faqe 223-225) konstatohet se F. përmes telefonit të tij me nr. ... , ka biseduar me A.B.1. i cili ka poseduar tel.nr..... i cili ka qenë i punësuar në kafe barin e R.Th.ku

A. pyet cilën me ta pru, cilën edhe njëherë me ta pru , ata me flokë të bardha a ata me flok të zeza.

Klienti-F. : ajo që i ka flokët e bardha .A. : ajo e zajihta apo ajo e shnosha .

Klienti- F.: jo jo ajo që është pak e shnosh që i ka flojkët e bardha qe i ka nja .

A.: Flokët e bardha të shkurta.

Klienti F.: te shkurta pak si e plot qe tha e Ruisis jam.

A.: aha qat T..

Klienti F.: po.

F. : ka pritur në hotel E.

Nga listingu 26.06.2012, vërtetohet se i akuzuari F.B. ka komunikuar me A.B.1. i cili ishte punësuar në lokalin e R., dhe F. ka kërkuar femrat të cilat punonin te R.Th. që të ja dërgon në hotel E., ku ishte duke pritur F. femrat për ti shfrytëzuar për marrëdhënie seksuale.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.B. , av.B.T.e kundërshton përmbajtjen dhe elementin inkriminues, sepse këtu nuk është vërtetuar se ka qenë bisedë serioze është anashkaluar fakti se ka qenë humor dhe nuk është vërtetuar gjendja esull e të akuzuarit, se ku ka qenë i dehur.

Sa i përket kundërshtimit të mbrojtësit të akuzuarit F.B. , av.B.T.se nuk ka qenë bisedë serioze dhe se është anashkaluar fakti se ka qenë humor dhe nuk është vërtetuar gjendja esull e të akuzuarit, se ku ka qenë i dehur, nuk qëndron, meqenëse mbrojtësi i të akuzuarit mundohet që të mohon faktin se bisedat telefonike të zhvilluara në mes të akuzuarit dhe dëshmitarit A. ti tregon si të pavlefshme, duke anashkaluar se biseda me përmbajtje të njëjtë këtu i akuzuari F. ka zhvilluar dhe diskutuar edhe me pronarin e lokalit R.Th., ku vërtetohet edhe me listingun e datës 28.06.2012, e i cili është cekur më poshtë.

-Nga listingu i datës 28.06.2012. konstatohet se R.Th. ka komunikuar nga tel nr. ... me personin NN me numër tel..., ku R. e njofton se deri qitash tu bo fjalë me ta kesh, personi NN me F. aaa; personi NN: pse? R. i thot: Po more, ju kishin pas ba 9018 euro aty plus 2000 euro përpara plus edhe nja 400 euro janë në hotel edhe 550 i ka F. borxh poj del edhe 900 e diçka euro mu la për...

Edhe nga kjo bisedë në mes të R.Th. dhe F. B., konstatohet se F., ka zbatuar borxhin nga R. duke i shfrytëzuar - femrat që kanë punuar në lokalin e R. në kafe bar L., për shërbimet seksuale, si dhe shpenzimet për ushqim dhe pije dhe hotele.

-Me listingun e datës 28.06.2012. (faqe 254) nga biseda e zhvilluar në mes të R.Th. me numër të tel.... dhe F.B. me numër të tel..., konstatohet se R. dhe F. kanë biseduar rreth shpenzimeve të bëra me rastin e shpenzimeve për pije , hotele dhe shërbimet për marrëdhënie seksuale me vajzat e punësuara te R.Th. , në lokal, F.B. së bashku edhe me shokë. Ku R. i tregon F. se kanë bërë shpenzime prej 9018 euro, ku i ka faturat për këto shpenzime. F. i kundërshton këto shpenzime duke i thënë se shpenzimet janë 5000- 6000 euro. R. i thotë se vetëm një faturë e ke 2114 euro, kur keni qen tre shok, F. e kundërshton duke i thënë eksik 2000 euro dhe i thotë se kemi qenë 5 herë, R. e kundërshton i thotë jo tash unë të tregoi sa herë ke qenë 1,2,3,4,5,6, 7 je kanë 7 herë, F. ja kthen 7 herë ka dy mi 10 mi euro bajnë, R. jo 7 herë ka 2 mi bajn 14 mi , 9018 janë këtu. F. banë vërejtje qysh bre R. 2000 mi euro vet i treti për 2 sahat a.

Gjykata konstaton, se sipas bisedës që ka zhvilluar përmes telefonit R.Th. me numër të tel....pronarin të kafe Bar “ L.” është vërtetuar së i akuzuari F.B. , ka shfrytëzuar për marrëdhënie seksuale femrat që punonin në lokalin e R.Th. dhe për këto marrëdhënie seksuale me femrat e punësuara te R.Th. ka shpenzuar më lart.

-Shikohet dhe lexohet listingu i datës 30.06.2012. Në këtë listing, konstatohet se shokët e të akuzuarit F. kanë komunikuar me R.Th. pronarin e lokalit K. B.“L.” në të cilin lokal punonin femrat e trafikuar, e të cilat shfrytëzoheshin për marrëdhënie seksuale, ku të njëjtin i thonë R. : Unë jam shok i F., F. ma dha numrin, dhe i tregojnë se janë në Prishtinë poashtu i thonë P. me ardh po tham të vetum, a je tu punu a jo? , ku R. iu përgjigjet : Po., të njëjtin thonë : Okej, pra hajt.

Edhe nga kjo bisedë në mes të shokëve të F. me R., konstatohet se F. e ka frekuentuar këtë lokal dhe iu ka propozuar edhe shokëve të tij që ta vizitojnë lokalin e R., me qëllim të shfrytëzimi seksual të punëtoreve të tij të cilat ishin të trafikuar. Se në të kundërtën shokët e F. nuk kanë pasur çka të shkojnë në lokalin e R., në emër të F.

Pas kësaj, gjykata vazhdon me mbrojtjen e të akuzuarit, thirret i akuzuari që të parashtrojë mbrojtjen e tij.

MBROJTJA E TË AKUZUARIT

I akuzuari F.B. deklaron se do të mbrohet në heshtje.

Meqenëse i akuzuari do të mbrohet në heshtje lexohet deklaratat e tij të dhëna në polici me datë 16.10.2012 , ku ka deklaruar:

Se e njej personin R.Th., prej afërsisht 5 viteve ku na ka lidhër tregtia e automjeteve dhe biznesit të tije me beton dhe kocka të betonit . Unë me R. kemi bërë biznes me automjete ku unë i kam shit disa automjete R. dhe i kam blerë disa të tjera, ku çdo gjë ka qenë në rregull deri sa kur i kam shitur një automjet të tipit M. si dhe një tjetër të tipit A., këto automjete ja kam shitur diku afërsisht para 4 muajve.

Nuk kam pas ndonjë problem mirëpo për këto të undit me ka mbetur borxh rreth 30.000euro (tridhjetë mijë euro), ku në fillim mi ka dhënë 3.900 euro (tre mije e nëndqin euro) , pastaj ma ka dhënë një automjet të tipit pasat në vlerë prej 6.000 euro (gjashtëmijë euro) , më pas kur kam kërkuar shumën e parave të tjera që mi kishte borxh ai ka fillu te mi llogarit në marrëdhëniet seksuale më femrat të cilat kanë qenë duke punuar në lokalin e R.Th. në Gjakovë.

Unë kam shkuar shpesh në lokalin e R.Th. dhe ai më ka thënë zgjidhe ndonjëren prej femrave për marrëdhënie seksuale nëse ke dëshirë të cilat kanë qenë duke punuar në lokal dhe Unë shpesh kam qenë aty me shokët e mi dhe i kemi marr femrat për marrëdhënie seksuale të cilat realisht ne kemi shkuar në hotel E. si dhe në hotelet tjera aty afër dhe R.Th. femrat i ka dërguar me taksi tek ne në hotel ku kemi qen duke i pritë, pastaj kur unë e kam thirre për borxh R. në telefon , ai mi ka llogarit faturat në emër të maradhënieve seksuale duke thënë se ti së bashku me shokët e tu keni bërë shpenzime në vlerë prej 9.400 euro (nëntëmijë e katërqind) .

Po unë rreth dy javë kam shkuar aty shpesh , nuk di sa herë , me shoqëri ku njëherë me kujtohet kam qen me tre shok kurse herëve tjera kam qen vetëm me një shok , kur R. na ka ofruar femrat për marrëdhënie seksuale ne i kemi pranuar, pastaj R. i ka llogarit në emër të borxhit.

Unë kamë qenë edhe më herët para këtij borxhi dhe kam pas marrëdhënie seksuale me femrat që kanë punuar në lokal të R. dhe kam paguar shumën prej 150 euro për një orë.

Zakonisht me R. e kam bërë marrëveshje, vetëm në raste se nuk ka qenë R. aty kam bërë marrëveshje me femrat për marrëdhënie seksuale.

Zakonisht R. i kam dhënë parat, mirëpo ka ndodhë që edhe atyre femrave i kamë dhënë parat.

Shumicën e herëve kam qenë me N.H. përveç një herë kamë qenë së bashku edhe me dy shok të tjerë D.B.dhe A.D.

N.H.e kam shokë të mirë i cili është nga KK Fushë Kosovë , kurse D.B.është nga KK Lipjan dhe A.D.nga KK Skenderaj janë shok të cilët vetëm për qef.

N.H. e njeh mirë e ka njofto edhe ma herët, ndërsa këta të tjerët nuk e besoj që e njohin.

Në pyetjen A e ka din N.H. që R.Th. po zbaton borxhin e juaj me marrëdhënie seksuale.

I akuzuari F.B. është përgjigjur: Po e ka ditë , sepse në një moment është befusuar dhe ka thënë se skemi mujt me bërë aq shum shpenzime.

Nuk ia din emrin mirëpo një person i cili punon në lokalin R. e njoh, ka qenë i dobët mirpo emrin nuk ja di.

Ka biseduar me telefon me këtë person. Zakonisht e ka pyetur ku është R., si dhe një herë e ka pyetur ku janë femrat se nuk erdhën në hotel.

L. është një person nga Gjakova , emrin nuk ja di , e njoh përmes R.Th., kur R. një herë mi ka pru 3900 euro L. ka qenë me R. dhe me pas unë me L.kemi shkuar për Gjakovë ndërsa N.H. me R.Th.

Në pyetjen Me atë personin e dopt që e përmendët më herët, a keni bërë marrëveshje për të marr ndonjë femër për marrëdhënie seksuale .

I Akuzuari përgjigjet: Po kam bërë marrëveshje , një herë më kujtohet kur kamë thirr në telefon sepse R. ka qenë nën ndikim të alkoolit dhe e kamë thirrë këtë pëson në telefon dhe i kam treguar cilën nga femrat me na sjell në hotel.

Në pyetjen: A jeni friguar ndonjëherë nga R. sepse ai është duke ju bërë ndonjë dredhi.
I akuzuari është përgjigjur: Po, njëherë kur janë rreh dy persona në lokalin e tij kam menduar se ai me qëllim e ka bërë atë për mos me shku unë në Gjakovë për mi kërkuar borxhin. Pyetje: A te ka borxh R. tash.

Përgjigje: Po mi ka edhe 8500 euro (tetëmijë e pesëqind)

Pyetje: Sa mendon ti se ke shpenzu në lokalin e R. për marrëdhënie seksuale .

Përgjigje: Sipas mendimit tim unë kam mundur ti shpenzoi rreth 5000 euro (pesëmijë) mirëpo R. i ka llogarit qysh ka dashtë ai vet dhe në këtë vlerë ai e ka rrit e ka bërë 9400 euro (nëntëmijë e katërqind) .

Pyetje: A ju ka caktuar vendin ku keni me kryer aktin seksual apo ju vet e keni zgjedh.

Përgjigja: Jo R. na ka caktuar që të shkojm , ku zakonisht na ka thënë që të shkojm në hotel E., i cili është afër lokalit të R. , mirëpo ka pas raste edhe në hotelet të tjera mirëpo në kohën e fundit gjithmonë na ka thënë në hotel E.që të shkojm.

Pyetje: A ju ka caktuar dhomën e hotelit , apo kur keni shkuar vet ju e keni zgjedhe.

Përgjigje: Ne kemi shkuar vet në hotel E., kemi besiduar me receptionistin dhe e kemi pyetur a ka dhoma të lira sepse na vinë femrat nga lokali i R. , pastaj ata na i kanë treguar dhomat.

Pyetje : Kush i ka paguar dhomat

Përgjigje: Ka pas raste kur kemi paguar vet, mirëpo shumicën e rasteve kur kemi shkuar në recepcion ja kemi dhënë në telefon receptionistin dhe unë nuk jam marr me pagesë t dhomës , sigurisht R. e ka paguar.

Pyetje : A e njihni pronarin e hotel E..

Përgjigje: E njohë si figurë , e di që e ka emrin M. më tepër nuk di,

Pyetje: A mendon që ka pas lidhje R.Th. me pronarin e hotel E. për ti dërguar femrat për marrëdhënie seksuale në atë hotel.

Përgjigje: Nuk di për këtë , vetëm e di se kanë pas shoqëri shumë të mirë ne mes vete.

Pyetje: A keni të shtoni diçka në lidhje me këtë deklaratë.

Përgjigje: Unë dua të them se kohëve të fundit jo pse kam dashtë të shkoj në lokal mirëpo ma ka imponu për shkak të borxhit dhe sa herë kam shku me ka gënjyer pastaj me ka dhënë femra etj., ndërsa për qef kur kam dashtë kamë shkuar në kohën e mëhershme para borxhit, diçka tjetër nuk kam të shtoj.

Pyetja: A keni ndonjë vërejtje gjatë marrjes në pyetje apo ndonjë presion.

Përgjigje: Jo nuk kam vërejtje, kjo deklaratë është e vullnetit tim dhe e gjitha kjo që e kam thënë më lart është e vërtet.

Gjykata lexon procesverbalin mbi intervistimin e të akuzuarit në prokurori PPS.Nr.63/11, me datë 30.04.2013.

Prokurori: A keni kuptuar të drejtat dhe detyruara të theksuara më lart?

I akuzuari: Po , të drejtat e mia i kam kuptuar për mbrojtës kam angazhuar avokatin I.I. i cili është prezent në sallë dhe dëshiroj të jap deklaratë dhe të përgjigjem në pyetjet e parashtruara.

Prokurori: Me qenë se ju nuk jeni përgjigjur ftesave të prokurorisë dhe Gjykatë për të qenë dëshmitarë bashkëpunues dhe tani jeni në cilësinë e të akuzuarit a mbetesh edhe më tutje ashtu siç keni deklaruar para meje dhe pranë deklaratës të dhënë në polici më datë 16.10.2012 në cilësinë e dëshmitarit?

I akuzuari: Sigurisht që po.

Prokurori: A keni që të shtoni diçka tjetër për veç deklaratave që i keni dhënë në polici me datë 16.10.2012 dhe në Prokurori me datën 08.01.2013?

I akuzuari: Nuk kam diçka tjetër të shtoj .

Prokurori: Cila ka qenë arsyeja që nuk ju jeni përgjigj ftesave të policisë , Prokurorisë dhe Gjykatës?

I akuzuari kam një vëlla të sëmur dhe gjendet në spital në Slloveni .

Prokurori: Pse nuk keni lajmëruar Policinë, Prokurorinë apo Gjykatën për këtë?

I akuzuari: Për shkak se nuk kam ditur se si shkojnë këto punë, aty është gabimi im, kërkoj falje për këtë.

Prokurori? Edhe sa ju ka mbetur borxh juve R.Th. ?

I akuzuari: Borxhin R.Th. tani e ka kryer, mi ka dhen dy automjete diku para 2 apo 3 muajve.

Prokurori: Përveç me N.H. a keni qenë ndonjë herë me ndonjë person tjetër në kafe bsrin e R.Th.?

I akuzuari: Po, kam qenë me plotë shokë.

Prokurori: Kush ka paguar më shumë kur keni shkuar në lokalin e R.?

I akuzuari: Më së shumti kam paguar unë në atë mënyrë që R. ato shpenzime mi ka rrëzuar në borxh ashtu që unë nuk kam pasur nevojë që ti jap para R. as për shpenzimet që i kam bë për pije as për femrat i kemi marrë për shërbime seksuale.

Prokurori: Meqenëse deri me tani ju nuk ju keni përgjigjur ftesave a mund të të tregoni

Prokurorisë se cila është adresa e saktë e juaj për ti dërguar ftesat?

I akuzuari: .. Komuna Prishtinës.

Avokati I.I.: I nderuar Prokuror dua të deklaroj në emër të të akuzuarit se unë dhe i akuzuari marrim përgjegjësi që të lajmërohemi në çdo kohë kur të na thirrni ju apo Gjykata në çdo kohë . andaj kërkojmë nga ju që mundësisht të i ja ndërpritni masën e ndalimit të akuzuarit dhe të mos kërkonit caktimin e paraburgimit .

Prokurori: A keni diçka tjetër për të shtuar lidhur më këtë çështje ?

I akuzuari: Jo, tjetër nuk kam çka të shtoj.

Procesverbali me shkrim më është lexuar në gjuhën shqipe e kam kuptuar e pranoj si timen dhe unë e nënshkruaj atë pa asnjë vërejtje.

Gjykata edhe pse i akuzuari F.B. ka heshtur gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka analizuar dhe vlerësuar deklaratën e tij të dhënë në staciononin policor dhe në prokurori, ku e ka pasur mbrojtësin e tij e të cilave deklarime Gjykata ua ka falur besimin pasi deklarimi i tij ka qenë në përputhje dhe në harmoni me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor si :

Nuk është kontestuese se i akuzuari F.B. , e njef R.Th. pronarin e lokalit ‘ L.’ , po ashtu nuk është kontestuese se ka qenë disa herë në lokalin e R.Th. në Gjakovë, se R.Th. i ka pas borxh F. tridhjetë mijë (30.000,00 €) se një pjesë të borxhit ja ka paguar R.Th. , kurse një pjesë ja ka kompensuar me shërbime seksuale me femrat të cilat ishin duke punuar te R., duke shkuar F. herë me shok e herë vetëm.

Se i akuzuari F.B. , ka shfrytëzuar femrat të cilat punonin te R.Th. , vërtetohet edhe nga deklarata e F.B.e dhënë në Polici sipas procesverbalit DKKO-DHTQNJ 2012 –DHTQNJ – 71 datë 16.10.2012 Prishtinë, ku kishte deklaruar se R. i kishte borxh afër 30.000,00 €, në fillim në emër të borxhit ja ka dhënë 3.900,00 €, pastaj ja ka dhënë edhe 6.000,00 €, me pas kur ka shkuar për të kërkuar borxhin për shumën e mbetur R. ka filluar të llogarit edhe marrëdhëniet seksuale me femrat që kanë qenë duke punuar në lokalin e R. në Gjakovë.

I akuzuari F. ka shkuar shpesh në lokalin e R.Th. në Gjakovë dhe ai i thoshte zgjidhë ndonjë femër nëse ke dëshirë, për marrëdhënie seksuale dhe kështu i kanë marrë femrat dhe kanë shkuar në hotel " E." në Gjakovë, dhe hotelet tjera aty afër, të cilat i sillte me taksit tek hoteli ku kanë qenë i akuzuari ndonjëherë edhe me shokët si N.H., D. B. dhe A.D.. Pastaj R. ja ka llogarit faturat në emër të marrëdhënies seksuale duke i thënë se ti së bashku me shokët e tu keni bërë shpenzime në vlerë prej 9.400,00 €.

Ka pas raste kur ka shkuar vetëm edhe kur ka paguar femrat për marrëdhënie seksuale deri në shumën prej 150 €.

Edhe në deklaratën e dhënë në Prokurorin Speciale të Kosovës PPS.nr. 63/11 datës 30.04.2013, i akuzuari F.B. , ka deklaruar se në lokalin e R.Th., ka qenë me plot shok dhe se më së shumti ka paguar i akuzuari F., në atë mënyrë që R. ato shpenzime ia ka rrezua në borxh ashtu që ky nuk ka pasur nevojë që ti jap para R. as për shpenzimet që i ka bërë për pije, as për femra që i ka marr për shërbime seksuale.

Deklaratën e të akuzuarit F.B. të dhënë në Polici dhe në Prokurori, e vërteton edhe dëshmitari N.H. në deklaratën e tij si dëshmitarë bashkëpunues të dhënë në Gjykatën Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PPS.nr. 61/11 datës 07.02.2013.

Edhe nga deklarata e dëshmitarit A.B.1. të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari F.B. , ka qenë në lokalin e R.Th. dhe ka marrë femrat të cilat kanë qenë duke punuar në lokalin e R., ka paraprakisht ka komunikuar me telefon me dëshmitarin A. B.1., i cili ka qenë i punësuar në lokalin e R.Th. t, të cilat femra dëshmitari A. ja ka dërguar me taksit deri në hotelin ku ishte duke pritë i akuzuari F.B. herë vetëm e herë me shokë.

Nga sa u tha më lartë Gjykata pa dyshim ka vërtetuar se i akuzuari F.B. e ka kryer veprën penale të trafikimit me njerëz nga neni 139 par.5 të ish Kodit Penal të Kosovës, cili e ka ditë se femrat të cilat ishin trafikuar nga R.Th. (i cili me aktgjykimin PKR.nr.90/16 datës 29.03.2016 është dënuar për veprën penale të trafikimit) se këto femra janë shfrytëzuar nga i akuzuari F. për marrëdhënie seksuale për të kompensuar borxhin që ia kishte R.Th., edhe pse e dinte se femrat që i shfrytëzonte për marrëdhënie seksuale ishin viktima të trafikimit dhe përkundër kësaj ai i shfrytëzonte për qëllime seksuale.

Nga sa u tha si më lart Gjykata pa dyshim ka vërtetuar se i akuzuari F.B. me dashje i ka shfrytëzuar femrat në lokalin e R.Th. në Gjakovë, për marrëdhënie seksuale edhe pse e dinte se këto femra ishin viktima të trafikimit dhe përkundër kësaj i shfrytëzonte për qëllime seksuale disa herë përkatësisht në ditë të ndryshme herë vetëm e herë me shokët e tij, deri sa e ka kompensuar borxhin që ja kishte R.Th. pronar i lokalit " L." në Gjakovë.

Pas përfundimit të procedurës së provave dhe pas dëgjimit të mbrojtjes së të akuzuarit dhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç janë: dëshmitë e dëshmitarëve R.Th., A.B.1. dhe N.H. nga deklarata e të akuzuarit të dhënë në polici më datë 30.11.2012, deklarata e dhënë në prokurori më datë 16.10.2012, dhe më datë 08.01.2013 (deklarata e dhënë në prokurori më datë 08.01.2013, me propozim të mbrojtësit të akuzuarit dhe me aprovim të gjykatës është veçuar nga shkresat e lëndës.)

Listingjet e datës 26.06.2012, në orën 02:45, 26.06.2012, në orën 03:00 dhe 26.06.2012, në orën 03:14/h, listingu i datës 28.06.2012, listingu i datës 30.06.2012.

Nga gjendja faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij Aktgjykimi pa dyshim rrjedhë se në veprimet e të akuzuarit F.B. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale trafikimi njerëzve nga neni 139 par.5 të ish KPK-së.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do të zvogëlonin ose përjashtonin përgjegjësinë penale të të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.5/3, të KPK-së.

Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin F.B., Gjykata mori gjendjen e tij ekonomike, se i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes, kjo kishte ndodhur për herë të parë, se është baba i një fëmije të mitur, e duke i vlerësuar këto rrethana lehtësuese konform nenit 73,74 dhe 75 të KPRK-së të akuzuarin e gjykon si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilin do të arrihet dhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuara me nenin 73 par.1 të KPRK-së, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur të shoqërisë.

Gjykata po ashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do t'iu shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen dhe ky dënim do të ketë efekt preventive gjenerale për personat e tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 par.1 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas shpalljes së këtij aktgjykimi gjyqtari i udhëzojë palët me të drejtë ankese, se mund t'ia parashtronë në përputhje me nenin 368. Par.1 të KPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr. 47/18, datë 29.05.2019

Zyrtarja ligjore,

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,

Arbënore Basha

Gëzim Pozhegu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2018:009197
Datë: 29.05.2019
Numri i dokumentit: 00335007